

RENDI I DITËS

**"Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.88, me subjekt ankues: Partia
Drejtësi Integrim dhe Unitet".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S'ka
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. L. Braho: Përshëndetje çëlim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 88 me ankues subjektin zgjedhor Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet me gërmanistore PDIU. Objekti i ankimimit është kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.545 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore Bashkia Lezhë. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore Bashkia Lezhë, për këshillat bashkiak. Objekti i ankimimit është korrigjuar në seancë paraprake, duke qenë se si fillim ka qenë për vendimet e KZAZ-së. Në seancë paraprake u vendos kalimi për shqyrtim në seancën e sotme, ju la detyrë palës ankimuese që të paraqiste indiciet apo provat në lidhje me pretendimet që kishte. Sot shohim që pala ankimuese nuk është paraqitur. Trupa e KAS përbëhet nga 4 anëtarët dhe është kuorumi për të zhvilluar këtë seancë. I pranishëm është Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së zoti Sekretar i

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.06.2023*

përgjithshëm me pak fjalë meqënëse mungon pala ankimuese çfarë keni ju për të thënë në lidhje me këtë kërkesë ankimore.

Z. Y. Merkaj: Duke qenë se kërkesa pala ankuese e ka braktisur nuk është paraqitur në këtë shqyrtim administrativ. Duke iu referuar edhe arsyetimit të kërkesës ankimore konstatohet që është një kërkesë që nuk ka bazë ligjore, janë fjalë të përgjithshme. Ka pasur pa rregullsi thotë por nuk tregon me detaje që ku janë pa rregullsitë dhe cilat provave pretendon të marri për të vërtetuar këto pa rregullsi. Në këto kushte duke qënë se kërkesa është e pa qartë, e pa argumentuar kërkojmë rrëzimin e kërkesës ankimore nr.88 me ankues Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, e cila ankimon vendimin e Komisionerit nr.545 datë 23.05.2023 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për Bashkinë Lezhë, faleminderit.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë duke qenë se pala nuk është paraqitur, nuk ka sjellë as prova në lidhje me pretendimet që kanë, në lidhje me rinumërimin e fletëve të votimit në dy KZAZ në KZAZ-në nr. 12 dhe nr. 13 Lezhë. KAS i konsultuar në vend në zbatim të nenit 143 pika 1 shkronja d të Kodit Zgjedhor vendos rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.545 datë 23.05.2023 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për zonën zgjedhore Bashkia Lezhë. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të KQZ-së ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi. E deklarojmë seancën të mbyllur.

Vendimi nr. 171

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



RENDI I DITËS

**"Për mos kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.71, me subjekt ankues:
Aleanca Progresiste LZHK".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z. Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S'ka
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Përshëndetje! Çelim seancën e shqyrtimit paraprakë për kërkesën ankimore nr.71 me objekt kundërshtimin e vendimit të KZAZ për tabelën përmbledhëse të KZAZ Tropojë. Relatojmë se kjo kërkesë ankimore është trajtuar paraprakisht në një seancë të mëparshme duke i lënë palës ankuese afatin 24 orë për të plotësuar me prova dhe me argumente dhe me arsyetim ligjor kërkesën e cila në vetvete përmban objektin dhe ka vetëm dy paragrafë pa shtjellim për çfarë pretendohet aq më pak prova, fakte dhe argumente. Duke qenë se të pranishëm KAS me 4 anëtarë si dhe Sekretari i Përgjithshëm. Zoti Ylli, kemi ndonjë plotësim apo...

Z. Y. Merkaj: Seanca paraprake ka qenë me dt.30.05.2023 është lënë 24 orë afat për plotësimin e kërkesës palës ankuese në datën 31.05.2023 ora 16 e 30, duhet të sillte provat për të plotësuar kërkesës si vendimit të KAS. Pala ankuese nuk i ka sjellë brenda këtij afati kështu që edhe sot e kësaj dite nuk kemi kërkesë për plotësimin me

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.06.2023*

prova. Në këto kushte i kërkojmë KAS mos kalimin e kërkesës në seancë për shqyrtim, faleminderit!

Z. K. Bele: KAS i konsultuar në vend, vendos mos kalimin e kësaj e kësaj kërkesë për shqyrtim. Me kaq ky vendim është i formës së prerë dhe hynë në fuqi menjëherë si dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi bëhet ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative Tiranë. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 172

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



RENDI I DITËS

**"Për mos kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.92, me subjekt
ankues: Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** S'ka
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëditë të gjithëve. Deklarojmë të hapur seancën publike për shqyrtimin e kërkesës ankimore me nr.92 të datës 27.05.2023 me subjekt ankimues Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet me obejkt të kërimit kundërshtimin e vendimit të KZAZ nr.52 të Bashkisë Librazhd për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore Bashkia Librazhd, ndryshimin e kësaj tablele përmbledhëse dhe pasqyrimin në të të rezultateve të reja sipas pretendimit të ankimuesit. Ankimuesi ka sqaruar në seancë paraprake që kundërshton vendimin nr.592 datë 16.05.2023 sikurse thamë të KZAZ nr.52. Relatori i kësaj çështje jam caktuar unë anëtari Elvis Çefa verifikojmë fillimisht prezencën është prezent trupa e KAS në përbërje të së cilës janë 4 anëtarë, për arsye objektive njëri nga anëtarët e ka të pa mundur të jetë prezent por kjo nuk e pengon këtë trupë që të vijojmë shqyrtimin normalisht të kësaj kërkesë për sa kohë numri konsiderohet i arritur. Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e tij. Nuk është

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.06.2023*

prezent pala ankuese. Zoti Sekretar i Përgjithshëm a kemi ndonjë kërkesë paraprake?

Z. Y. Merkaj: Po pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa me nr. Protokolli datë 5732 datë 1.06.2023, ku pala ankuese kërkon të heqi dorë nga ankimi i kërkesës ankimore nr.92. Në këto kushte i kërkojmë KAS pushimin e çështjes.

Z. E. Çefa: Atëherë për rekord kërkesa në fjalë pra e datës 1 Qershor 2023 e paraqitur nga zoti Shkëlqim Sulo, i cili është edhe personi i autorizuar nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet që të përfaqësoj atë në marrëdhëniet me KQZ-në thotë citoj: “Duke qenë se kemi analizuar provat dhe faktet mbi ankimin e depozituar nga subjekti ynë zgjedhor, kërkojmë të tërhiqemi nga ankimi menjëherë nga depozitimi i kësaj kërkesë”. Në këto kushte KAS i konsultuar në vend, vendosi pushimin e shqyrtimit të kësaj kërkesë për shkak të tërheqes së subjektit nga ankimi. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së, ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda afatit 5 ditor në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 173

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

